

- Përveç duhanit një ves tjetër i dëmshëm është edhe alkoholi. Edhe ky ves është shkaktar i një vargu sëmundjesh duke filluar që nga aparati tretës, mëlçia, pankreasi e deri në dëmtime të pariparueshme të sistemit nervor qendror. Në mëlçi alkoholi i konsumuar shkakton dëmtime të qelizave hepatike, dëmtim që përpëron në kohë dhe që varet nga doza e konsumuar dhe nga veçoritë fiziologjike të individit. Është vërtetuar se sasia e rrezikshme është ajo prej 20-40g alkohol etilik, ndërsa përdorimi 100-150g alkohol në ditë, çon brenda një periudhe 10-vjeçare në cirozë. Nga ana tjetër është vërtetuar edhe shkencërisht se për shkak të fiziologjisë femrat dëmtohen shumë më shpejt



se meshkujt për të njëjtën sasi alkoooli të konsumuar. Njerëzit që pinë me vite nuk ndjejnë asgjë papritur një ditë gjenden para një fakti të hidhur, mëlçia e tyre ka marrë fund, është kthyer në një mëlçi cirotike, ose kanë shqetësime të lehta që nuk ja vënë veshin, por bukur mirë ata bëjnë puthjen e parë me vdekjen.



Punoi: Frenci Rakipi

Në kimi, alkohol është çdo komponim organik në të cilin grupi hidroksil (-OH) shoqërohet me atom karboni nga një alkil ose grup alkilik.

Formula e përgjithshme e një alkoholi aciklik është $C_nH_{2n+1}OH$.

Me fjalë tjera alkohol i referohet etanolit, lloj alkoholi që është pjesë përbërëse e pijeve alkoholike.

Varshmëria nga alkoholi quhet alkoolizëm.

Informacion rreth demit qe i bejme trupit tone duke pije pije alkoholike

Rreth alkolit dhe pijeve alkoholike


Alkoli

Te keqijat
Demet
Si prodhohet
Vetite



Punoi: Frenci Rakipi

Informacione rreth alkoolit



Prodhimi

Mënyra më e vjetër e përfitimit e njohur para 6000 vjetëve e cila mbështetet në metodën e fermentimit të sheqerit, nën veprimin e disa substancave që i prodhojnë disa mikoroorganizma, që quhen enzime ose tharmer.

Vetitë

Vetitë e alkoolëve rrjedhin nga grupi hidroksil. Alkoolët mund të konsiderohen derivate të ujit, ku një atom hidrogjen zëvendësohet me një radikal. Alkoolët kanë veti të hidrokarbureve dhe ujit, p.sh: etanoli është i djegshëm (si edhe etani), dhe reagon me natriumin si edhe uji. Alkoolët në krahasim me hidrokarburet, kanë temperatura të vlimit dhe shkrirjes më të larta. Alkoolët tretën mirë në ujë. Alkoolët me 1 deri 3 atome karboni tretën mirë në ujë, me rritje të atomeve të karbonit zvogëlohet tretshmëria e alkoolit në ujë. Alkoolët zhvillojnë reaksione të shumta kimike nga të cilat formohen këto komponime: aldehidet, ketonet, acidet, esteret etj.

Alkoolët terciare nuk oksidohen.

Dëmet

Edhe pankreasi pëson dëmtime nga alkooli. Përdorimi i zgjatur i alkoolit e dëmton në mënyrë kronike pankreasin deri në atë shkallë sa ai nuk arrin të tajit sasinë e duhur të enzimeve për të kryer të plotë procesin e tretjes së ushqimeve. Është vërtetuar se konsumimi i 20-50g alkool etilik (rreth 100 ml raki) në ditë shkakton dëmtime, ndërsa pirja e 100g alkool etilik ose mbi dy dopio raki (200ml) apo 2 litra birra për një periudhë 6-12 vjet jep në mënyrë të sigurt dëmtime të pankreasit. Konsumimi për një kohë të shkurtër i një sasive të madhe pijesh alkoolike rrezikon për pankreatit akut që mund të çojë deri në rrezikimin e jetës. Alkooli shkakton gjithashtu dehe, atëherë sistemi nervor qendror nuk arrin të kontrollojë veprimet e vullnetshme, apo të pavullnetshme. Është vërtetuar se për çdo 1 litër alkool të konsumuar, vdesin 1.000-2.000 qeliza të trurit. Pra, alkooli dëmton pa përjashtim të gjitha organet e trurit.

Efektet e Alkoolit ne Tru

Nën ndikimin e alkoolit, truri përjeton probleme në funksionimin e zonave të ndryshme:

Lobi frontal : Humbje të arsytimit, shkakut, bllokimet, të folures dhe inteligjences

Lobi parietal : Humbje e levizjeve motore të holla, përgjigje motore e ngadalesuar, të dridhura

Lobi temporal: e folur e ngadalesuar, probleme me degjimin

Lobi ocipital: shikim i mjegulluar, probleme me llogaritjen e distancës së objekteve

Cerebelum : Moskoordinimin i muskujve dhe humbje e balancës gjatë levizjes

Rrenja e trurit : humbje e funksioneve jetesore

Produkti i reaksionit kimik me të vjetër të studjuar nga njeriu, alkoli, vazhdon të sjellë sfida kërkuesve. Që nga punët e para mbi efektet nervore të alkoolit mbi sistemin nervor në fillim shekullin e 20, teoritë e reja kanë dalë herë pas here. Ajo që kemi mesuar deri tani është që alkoli është sedativ - hipnotik në fazat akute toksike për shumicën e pacientëve. Ai ul kualitetin e gjumit. Individet me apne gjumi përjetojnë periudha me të gjata dhe me të renda episodet apnee dhe hipoksie ose mungesë të oksigjenit pasi konsumojnë alkool.

Birra

Birra është pija alkoolike më e vjetër dhe më e njohur në botë. Shiten më shumë se 133 miliardë litra birra në vit. Prodhohet nga tharmëtimi i lëndëve me bazë niseshten, zakonisht përdoret elbi, megjithëse përdoren edhe rrënjët e kasavës (Manihot esculenta) në Afrikë, patatja në Brazil, dhe Agava (lloj kaktusi) në Meksikë.

Vera

Vera është një pije alkoolike që prodhohet nga fermentimi i rrushit ose lëngut të rrushit. Fjala vjen nga Gjuha Greke për Fovoç dhe nga Gjuha Latine për vinum. Pije të ngjashme me verën mund të bëhen edhe nga fruta të tjera. Në këtë kuptim emri verë përdoret si kualifikues, për shëmbull, verë e kuqe. Vetë fjala verë ka kuptimin verë rrushi.

Punoi: Frenci Rakipi